



Prishtinë: 15.11.2018  
Kodi i ZRRE-së: V\_1072\_2018

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët;
- Rekomandimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_R\_1887\_11\_18**;

në seancën e mbajtur më datë 15.11.2018, nxori këtë:

### V E N D I M

- I. **APROVOHET** ankesa e konsumatorit "G. P." (përfaqësuar nga N. K.), si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II. **OBLIGOHET** Operatori i Sistemit të Shpërndarjes - KEDS që me shpenzimet e veta t'i ofroj aplikuesit "G. P." kyçjen në rrjetin elektrik të KEDS-it.

### A r s y e t i m

Pranë Zyrës së Rregullatorit për Energji me datë 01.08.2018 konsumatori "G. P." të përfaqësuar nga N. K. ka parashtruar ankesë me të cilën ka kundërshtuar përgjigjen e KEDS-it lidhur me mos lejimin e kyçjes në rrjetin e KEDS-it të objektit të "G. P."

Bordi i ZRRE-së, me qëllimit të vërtetimit të plotë gjendjes faktike e cila është iniciuar nga palët në kontest lidhur me pikën matëse të theksuar më lartë ka shqyrtuar dhe analizuar në detaje të gjitha dëshmitë e mbledhura për veprimet e ndërmarra nga palët në kontest lidhur me këtë pikë matëse.

Me datë 26.04.2017 Operatori i Sistemi të Shpërndarjes – KEDS sipas kërkesës së aplikuesit N. Rr. "G. P." Shpk ka lëshuar Pëlqimin Elektroenergjetik nr.4159 për veprimtarinë objekti minierë për përpunimin e qymyrit dhe me fuqi maksimale të njëkohshme prej 411 kW (sipas projektit).

**Provë:** Pëlqimi Elektroenergjetik nr.4159 i datës 26.04.2017

Me datë 21.07.2017 kompania Erpower e cila ka qenë nënkontraktor i kompanisë "G. P." ka parashtruar kërkesë për pranim teknik në KEDS për gurëthyesin "G. P." në fshatin Zatriq, dhe kjo bazuar në Pëlqimin Elektroenergjetik nr.4159 i datës 26.04.2017.

**Provë:** Kërkesa për pranim teknik nr.8240 e datës 21.07.2017

Me datë 28.07.2017 punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë dalur te konsumatori për të verifikuar se a janë plotësuar të gjitha kushtet teknike nga kompania në fjalë dhe për të përpiluar raportin teknik. Gjatë verifikimit punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë përpiluar Raportin Teknik dhe kanë konstatuar se janë plotësuar kushtet për energjizim të objektit.

**Provë:** Raporti Teknik i KEDS-it nr.8475 i datës 28.07.2017



Me datë 11.08.2017 konsumatori "G. M." ka parashtruar një kërkesë në KEDS duke kërkuar që të mos kyçin në rrjetin elektrik kompaninë "G. P" Power" në Largpërçuesin LP 10 kV të biznesit. Në kërkesë është theksuar se lidhur me dhënien e pëlqimit për kyçje të palës së tretë nga kompani "B" shpk në rrjetin e tensionit të lartë Zatriq, komuna e Rahovecit investim ky nga kompania "G. M" kërkon nga KEDS të ndërprerë aktivitetin e furnizimit me energji elektrike duke ndërprerë kyçjen e palës së tretë në përputhje me marrëveshjen e datës 24.03.2014 në mes të "G. M" Shpk dhe "B" Shpk.

**Provë:** Kërkesa e konsumatorit "G. M" në KEDS e datës 11.08.2017

Me datë 16.08.2017 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes – KEDS i është përgjigjur aplikuesit për kyçje N. Rr. "G. P." duke theksuar se KEDS me datë 26.04.2017 ka lëshuar PEE, megjithatë me datë 11.08.2017 në KEDS është parashtruar një kërkesë nga kompania "G. M" në të cilën është theksuar se është kërkuar mos kyçja e "G. P" në rrjetin elektrik e cila është private dhe është e kompanisë "G. M". Në përgjigje është theksuar se kompania "G. M" ka paraqitur një dokument (leje) nga kompania "B" e cila e ka lejuar kompaninë "G. P" të lidhet në linjën e cila i përket kompanisë "G. M". Gjithashtu KEDS në përgjigjen e tyre kanë theksuar se "G. M" kanë paraqitur edhe një dokument leje të nënshkruar në mes të "G. M" dhe "B" me datë 24.03.2014 e në të cilën theksohet se kompania "G. M" lejon kyçjen e kompanisë "B" në linjën e tij dhe se kompania që e merr këtë pëlqim nuk ka të drejtë të lejojë kyçjen e personit të tretë pa pëlqimin e "G. M". Andaj KEDS në fund ka theksuar se linja i takon kompanisë "G. M" dhe se dokumenti i lejes së paraqitur në mes të "G. P" dhe "B" është i pavlefshëm dhe se KEDS nuk mund të vazhdojë me kyçjen e pikës matëse deri sa të zgjidhet çështja e lejes me kompaninë "G. M", andaj KEDS kërkon nga "G. P" që të sigurohet lejen për kyçje nga linja private e "G. M".

**Provë:** Përgjigja e KEDS e datës 16.08.2017

Me datë 09.10.2017 kompania "G. P" ka paraqitur padi kundër të paditurës KEDS lidhur kompensimin e dëmit në shumën e papërcaktuar.

Me datë 01.06.2018 Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike ka nxjerr Aktvendimin me të cilën ka ndërprerë procedurën në këtë çështje kontestimore IV.EK.C.nr.462/17, deri sa të zgjidhet çështja paraprake nga ZRRE-ja se a ka të drejtë të kyçet paditësi në rrjetin kontestues, si dhe procedura do të filloj pas vendimit të ZRRE-së.

**Provë:** Aktvendimi IV.EK.C.nr.462/17 i datës 01.06.2018

Me datë 01.08.2018 kompania "G. P" i është drejtuar ZRRE-së lidhur me kërkesën e tyre për përgjigje në ankesën e tyre kundër KEDS të datës 13.09.2017 dhe sipas vendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë. Kompania në fjalë në ankesë ka theksuar se KEDS nuk po e lejon kyçjen në rrjetin elektrik. Kompania në fjalë ka theksuar se i vetmi pronar i linjave është KEDS për tensionin e ulët, ndërsa për tensionin e lartë është KOSTT sipas nenit 10 të ligjit për Energjinë Elektrike. Kompania "G. P" në ankesë ka theksuar se sipas nenit 10 të ligjit të lartcekur pronar i linjave është Operatori i Sistemit të Transmetimit. Sipas nenit 27 të Ligjit për Energjinë Elektrike "G. M" e nuk është Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sepse nuk është licencuar dhe se nuk mund të ndaloj kyçjen e konsumatorëve në rrjetin elektrik. Gjithashtu është theksuar se çdo ditë vonesë në kyçje e pamundëson operimin e kompanisë dhe shkakton humbje të madhe.

**Provë:** Ankesa e konsumatorit

Bordi i ZRRE ka analizuar me kujdes kërkesën e konsumatorit për kyçje në rrjet dhe Pëlqimin Elektroenergjetik (PEE) nr.4159 të datës 26.04.2017 dhe ka vërejtur se pas aplikimit të kompanisë "G. P" në KEDS për marrjen e Pëlqimit Elektroenergjetik, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes - KEDS me datë 26.04.2017 sipas kërkesës së aplikuesit N. Rr. "G. P" Shpk ka lëshuar Pëlqimin Elektroenergjetik nr.4159 për veprimtarinë Objekti minierë për përpunimin e qymyrit dhe me fuqi maksimale të njëkohshme prej 411 kW (sipas projektit). Vlen të theksohet se përveç tjerash në PEE potencohet se



për lëshimin e trafostacionit në punë kompania në fjalë duhet të sjell edhe lejen e noterizuar nga pronarët e pronave private.

**Provë:** Pëlqimi Elektroenergjetik nr.4159 i datës 26.04.2017

Bordi i ZRRE gjatë analizave të bëra shkresave të lëndës ka vërejtur se pas përfundimit të të gjitha punëve teknike nga ana e kompanisë “G. P” Powe”, punëtorët e autorizuar të KEDS-it me datë 28.07.2017 kanë dalur te konsumatori për të verifikuar se a janë plotësuar të gjitha kushtet teknike nga kompania në fjalë dhe për të përpiluar raportin teknik. Gjatë verifikimit punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë përpiluar Raportin Teknik dhe kanë konstatuar se janë plotësuar kushtet për energjizim të objektit. Pra sipas këtyre dokumenteve shihet qartë se kompania “G. P” ka plotësuar të gjitha kushtet teknike të dhëna në Pëlqimin Elektroenergjetik dhe se mbas kësaj ka mbetur vetëm energjizimi i objektit, respektivisht kyçja e konsumatorit në rrjetin elektrik.

**Provë:** Raporti Teknik i KEDS-it nr.8475 i datës 28.07.2017

Bordi i ZRRE thekson se në nenin 51, paragrafi 4 të Ligjit për Energjinë Elektrike, thuhet se: *“Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund ta refuzojë përkohësisht kyçjen e një konsumatori ose prodhuesi në sistem, nëse konstaton se pajisjet e konsumatorit apo të prodhuesit nuk plotësojnë normat teknike ose kushtet tjera të përshkruara në Kodin e rrjetit të transmetimit dhe Kodin e rrjetit të shpërndarjes. Konsumatori ose prodhuesi duhet të informohet me shkrim për arsyet e çdo refuzimi të tillë. Konsumatori ose prodhuesi i cili është refuzuar ka të drejtë të ankohet kundër një Vendimi të tillë tek Rregullatori, në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë. Operatori i Sistemit të Transmetimit ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes kyçin një konsumator ose prodhues pa vonesë deri në datën e përcaktuar nga Rregullatori në sistemin e tyre në rastet kur Rregullatori vendos mbi një ankesë në të mirë të konsumatorit ose prodhuesit në fjalë”*. Në nenin 10, paragrafi 1 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, thuhet se: *“Operatori i Sistemit mund të refuzoj të kyçë një aplikues përkohësisht, vetëm nëse ajo kyçje nuk është në përputhje me dispozitat e Kodit të Rrjetit dhe Shpërndarjes ose kodeve tjera në fuqi”*.

Sipas analizave të bëra shkresave të lëndës vërehet se kompania “G. P” ka paraqitur një pëlqim në mes të “G. P” dhe kompanisë “B”, në të cilën dokument theksohet se kompania “B” japë leje kompanisë “G. P” që të kyçet në tensionin e lartë e cila është pronë e firmës “B”, si dhe gjithashtu lejon vendosjen e shtyllave elektrike nëpër pronën e tyre. Gjithashtu është theksuar se kompania “G. P” nuk ka të drejtë të jep leje për kyçje për personin e tretë. Duhet theksuar se sipas KEDS-it, pas ankesës së konsumatorit “G. M” bërë në KEDS me të cilën është kërkuar mos kyçja e konsumatorit “G. P” ky dokument është i pavlefshëm pasi që linja në të cilën është marrë pëlqimi për kyçje është aset privat dhe se pronar i linjës, edhe përkundër që vet KEDS-i i ka dhënë aplikuesit Pëlqimin Elektroenergjetik dhe aplikuesi i ka bërë të gjitha punimet teknike në teren për të kyçur në rrjetin elektrik. Duhet theksuar se sipas nenit 51, paragrafi 4 i Ligjit për Energjinë Elektrike, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund ta refuzojë përkohësisht kyçjen e një konsumatori ose prodhuesi në sistem, nëse konstaton se pajisjet e konsumatorit apo të prodhuesit nuk plotësojnë normat teknike ose kushtet tjera të përshkruara në Kodin e rrjetit të transmetimit dhe Kodin e rrjetit të shpërndarjes. Pra sipas dispozitave ligjore të Ligjit për Energjinë Elektrike KEDS nuk mund të refuzojë aplikuesin i cili kërkon kyçje të energjisë, pasi që gjitha kushtet teknike të kërkuara nga KEDS për “G. P” janë plotësuar dhe këto janë dhënë edhe në Raporti teknik të vet KEDS-it. Lidhur me këtë Bordi i ZRRE konstaton se aplikuesi për kyçje “G. P” sipas kushteve teknike të dhëna në PEE ka ndërtuar tërë rrjetin elektrik të specifikuar në PEE dhe KEDS ka bërë pranimin teknik të të gjitha pajisjeve elektrike, andaj konstaton se KEDS me shpenzimet e veta duhet t’ia ofroj aplikuesit “G. P” kyçjen në rrjetin elektrik të KEDS-it .

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 15.11.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Arsim Janova, u.d. kryesues

---

Besim Sejfiqaj, anëtar

---

Selman Hoti, anëtar

---

Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Konsumatorit: "G. P" (përfaqësuar nga N. K.)
- KESCO-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së.